



REPUBLIKA E KOSOVES-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD CIVIL SERVICE OF KOSOVO



Pranuar / Dorezuar Puniljen / Prodato Received / Delivery	30.03.2022	2	viti god year
Organ / Njësia Organ / Jedinica Org./Unit	Nr. Prot Br. Prot Prot No	Shtesa Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKPM/STCK	1725/2022		111



Republika e Kosovës Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

Nr. 27 /2022
Datë: 30.03.2022

Në mbështetje të nenit 6 paragrafit 1 nën paragrafit 1.3, nenit 20 paragrafit 2, 4 dhe 5 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, nenit 10 të Rregullores Nr.01/2018 për Punën e Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, nenit 3, nenit 4 paragrafit 1 nën paragrafit 1.1, nenit 5, nenit 16 paragrafit 1 dhe 2 të Rregullores Nr.04/2018 për Procedurën e Monitorimit të Institucioneve të Administratës Publike lidhur me Zbatimin të Rregullave dhe Parimeve të Legjislacionit për Shërbimin Civil, si dhe nenin 2 paragrafi 5 të Rregullores Nr.02/2021 për plotësimin dhe ndryshimin e Rregullores Nr.04/2018, Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (*Këshilli*) në mbledhjen e pestë (V) të mbajtur më datë 30.03.2022, mori këtë:

V E N D I M

1. Miratohet Raporti i Kolegjit të Këshillit lidhur me vlerësimin e zbatimit të rregullave dhe parimeve të legjislacionit për shërbimin civil për vitin 2020 në Administratën Tatimore të Kosovës.
2. Drejtori i Përgjithshëm në Administratën Tatimore të Kosovës obligohet për zbatimin e rekomandimeve të dhëna në raport, brenda katër dhjetë e pesë (45) ditësh nga dita e pranimi të këtij vendimi.
3. Raporti me rekomandime është pjesë e bashkangjitur këtij vendimi.
4. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës duhet të njoftohet me shkrim pas zbatimit të rekomandimeve.
5. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Këshillit.


Jeton KOCA
Kryetar i Këshillit

Vendimi i dërgohet:

- Drejtorit të Përgjithshëm në Administratën Tatimore të Kosovës
- Menaxherit të Personelit në Administratën Tatimore të Kosovës
- Arkivit të Këshillit.



REPUBLICA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD CIVIL SERVICE OF KOSOVO

Pranuar / Dorezuar Primljeni / Prodato Received / Delivery	30.03.2022	viti god year
Organ / Njësia Organ / Jedinica Org / Unit	Nr Prot Br Pred Prot No	Shtojca Prilog Appendix
SKPMShCK	1725/2022	11/10



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBEKOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

RAPORTI I MONITORIMIT TË ZBATIMIT TË RREGULLAVE DHE PARIMEVE TE
LEGJISLACIONIT PËR SHËRBIMIN CIVIL

NË

ADMINISTRATËN TATIMORE TË KOSOVËS PËR VITIN 2020

Prishtinë, 2022

TABELA E PËRMBAJTJES

Hyrje	3
Funksioni i Monitorimit.....	3
Objektiva dhe metodologjia e monitorimit.....	3
Fushat e monitorimit.....	4
Raporti për monitorimin në Administratën Tatimore të Kosovës.....	5
Organizimi i Brendshëm dhe të Dhënat e të Punësuarve.....	7
Procedurat e Rekrutimit dhe të Avancimit.....	9
Procedurat Disiplinore.....	9
Procedurat e Ankesave.....	10
Procedurat e Vlerësimit.....	10
Procedurat e Pushimeve.....	12
Procedurat e Transferimit.....	12
Të dhënat për përfaqësim etnik, gjinor dhe personave me nevoja të veçanta.....	13
Pezullimi, Ndërprerja dhe Përfundimi i Marrëdhënies së Punës.....	13
Papajtueshmëria në mes të ushtrimit të detyrës së nëpunësit civil dhe funksionarit publik.....	15
Të dhënat nëse ndaj nëpunësve civil është duke u zhvilluar procedurë penale ose janë dënuar me vendim të gjykatës.....	15
Trajnimi i Nëpunësve Civil.....	15
Vijimi në Punë, Pagat, Shtesat dhe Kompensimet.....	15
Zbatimi i Rekomandimeve dhe Vendimeve të Këshillit.....	16
Ngacmimet Sekuale.....	16
Shënimet/komentet/konkluzionet e përgjithshëm për mbikëqyrjen e zbatimit të rregullave dhe parimeve të legjislacionit për shërbimin civil.....	16

HYRJE

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (në tekstin e mëtejshëm: Këshilli) Monitoron Institucionet e Administratës Publike Lidhur me Zbatimin e Rregullave dhe Parimeve të Legjislacionit për Shërbimin Civil.

Baza ligjore për ushtrimin e funksioneve të Këshillit është Kushtetuta e Republikës së Kosovës, Ligji Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Ligji Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë, Ligji Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës (për kohën kur ka qenë i aplikueshëm), Ligji Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Rregullorja Nr. 01/2018 për Punën e Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Rregullorja Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Rregullorja Nr. 04/2018 për Procedurën e Monitorimit në Institucionet e Administratës Publike Lidhur me Zbatimin e Rregullave dhe Parimeve të Legjislacionit për Shërbimin Civil si dhe ligjet dhe aktet nënligjore që ndërlidhen me shërbimin civil.

Këshilli përmes monitorimit të zbatimit të rregullave dhe parimeve në shërbimin civil angazhohet që të sigurohet një administratë profesionale dhe efikase, sipas standardeve evropiane.

FUNKSIONI MONITORIMIT TË KËSHILLIT

Në pajtim me Ligjin Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregullores Nr. 04/2018 për Procedurën e Monitorimit në Institucionet e Administratës Publike Lidhur me Zbatimin e Rregullave dhe Parimeve të Legjislacionit për Shërbimin Civil, përmes funksionit të monitorimit Këshilli bënë monitorimin e zbatimit të rregullave dhe parimeve të legjislacionit për shërbimin civil.

Për të ushtruar këtë funksion në mënyrën më të mirë, Këshilli ka miratuar Rregulloren Nr. 04/2018 për Procedurën e Monitorimit në Institucionet e Administratës Publike Lidhur me Zbatimin e Rregullave dhe Parimeve të Legjislacionit për Shërbimin Civil, mbi bazën e të cilit edhe harton "Planin e Monitorimit" në kuadër të të cilit përfshihen një numër i Institucioneve të nivelit qendror dhe lokal, si dhe organe të pavarura dhe agjenci qendrore në kuadër të këtyre Institucioneve, plan ky i cili miratohet nga Këshilli në çdo fillim viti.

OBJEKTIVA DHE METODOLOGJIA E MONITORIMIT

Objektiva e monitorimit ka për qëllim monitorimin e zbatimit të rregullave dhe parimeve të legjislacionit për shërbimin civil. Me qëllim të përmbushjes së përgjegjësisë për realizimin e objektivës sonë kemi zbatuar një kombinim të mostrave sipas gjykimit dhe sipas rastit në përzgjedhjen e dosjeve, dhe jemi mbështetur në një lloj kombinimi të intervistave me zyrtarët e personelit, rishikimeve analitike, rishikimin e dokumenteve dhe verifikimin fizik për të vlerësuar vlefshmërinë dhe rregullsinë e zhvillimit të procedurave dhe respektimin e legjislacionit të shërbimit civil.

FUSHAT E MONITORIMIT

Këshilli, gjatë implementimit të mandatit të tij lidhur me zbatimin e rregullave dhe parimeve të legjislacionit për shërbimin civil, ka përcaktuar fushat të cilat do të jenë pjesë e monitorimit në

kuadër të Divizioneve të Burimeve Njerëzore dhe mekanizmave tjerë të Institucioneve të cilët janë përgjegjës për zbatim të legjislacionit të shërbimit civil.

Në këtë kuadër si pjesë e mbikëqyrjes janë:

- Organizimi i brendshëm dhe të dhënat e të punësuarve;
- Procedurat e rekrutimit dhe të avancimit;
- Procedurat disiplinore;
- Procedurat e ankesave;
- Procedurat e vlerësimit;
- Procedurat e pushimeve;
- Procedurat e transferimit;
- Të dhënat për përfaqësim etnik, gjinor dhe personave me nevoja të veçanta;
- Procedurat e pezullimit, ndërprerjes dhe përfundimit të marrëdhënies së punës;
- Papajtueshmëria në mes të ushtrimit të detyrës së nëpunësit civil dhe funksionarit publik;
- Të dhënat nëse ndaj nëpunësve civil është duke u zhvilluar procedurë penale ose janë dënuar me vendim të gjykatës;
- Trajnimi i nëpunësve civil;
- Vijimi në punë, pagat, shtesat dhe kompensimet;
- Zbatimi i rekomandimeve dhe vendimeve të Këshillit;
- Ngacmimet Seksuale;
- Shënimet/Komentet/Konkluzionet e Përgjithshme për Mbikëqyrjen e Zbatimit të Rregullave dhe Parimeve të Legjislacionit për Shërbimin Civil

RAPORT PËR MONITORIMIT TË ZBATIMIT TË RREGULLAVE DHE PARIMEVE TË LEGJISLACIONIT PËR SHËRBBIMIN CIVIL NË ADMINISTRATËN TATIMORE TË KOSOVËS PËR VITIN 2020

Këshilli, gjatë procesit të monitorimit të zbatimit të rregullave dhe parimeve të legjislacionit për shërbimin civil në Administratën Tatimore të Kosovës për të vlerësuar drejtë në mënyrë të paanshme dhe të saktë gjendjen e ligjshmërisë së veprimeve të ndërmarra nga Administrata Tatimore e Kosovës përveç monitorimit të drejtpërdrejtë që ka zhvilluar gjatë realizimit të vizitës në Administratën Tatimore të Kosovës me datë 07.04.2021 dhe 23.12.2021, në prezencë të Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore, si mostra për shqyrtim ka marr një mori të kopjeve të dokumenteve relevante, si në vijim:

- Vendimin me Nr. 264 të datës 29.07.2020 për caktimin e zëvendës Udhëheqësit të Divizionit për Veprimet Themelore të Mbledhjes;
- Vendimin me Nr. 97 të datës 05.02.2020 për transferim në pozitën Zyrtar i Latë për rimbursime;
- Vendimin me Nr.134 i datës 21.02.2020 për caktimin e ushtrues të detyrës të Zyrtarit të Arkivës;
- Vendimin me N. 18 të datës 26.01.2021 për transferim të Inspektorit Tatimor;
- Vendimin me Nr. 265 të datës 27.07.2020 për caktimin e zëvendës udhëheqësi të Divizionit për Menaxhimin e Masave të Sforcuara;
- Vendimin e datës 03.02.2020 për transferim të përkohshëm në pozitën Inspektor i Kontrollit;
- Vendimin e datës 25.06.2020 për transferimin e përkohshëm në pozitën Udhëheqës i Ekipit në Departamentin e Hetimeve Tatimore dhe Inteligjencë;
- Vendimin e datës 08.06.2020 për transferimin në pozitën Inspektor Tatimor i Vizave në Drejtorin Rajonale Pr.2;
- Vendimin e datës 25.06.2020 për ushtrues detyre në pozitën Udhëheqës i Ekipit në Divizionin e Hetimeve Tatimore;
- Vendimin e datës 27.07.2020 për caktimin e zëvendësuesit Udhëheqës i Ekipit 2 në Divizionin për Menaxhimin e Masave të Sforcuara;
- Vendimin e datës 27.07.2020 për caktimin e zëvendësuesit Udhëheqës i Ekipit 1 në Divizionin për Rastet pas Veprimeve të Mbledhjes;
- Vendimin e datës 27.07.2020 për caktimin e zëvendësuesit të Drejtorit të Departamenti për Menaxhimin e Mbledhjes së Borxheve;
- Vendimin e datës 27.07.2020 për caktimin e zëvendësues të Drejtorit të Departamentit për Rimbursime dhe Qendra e Thirrjeve;
- Vendimin e datës 27.07.2020 për caktimin e zëvendësuesit të Udhëheqësit të Divizionit për Rimbursime;
- Vendimin e datës 27.07.2020 për caktimin e zëvendësuesit Zyrtar të Lartë për Ribursime;
- Vendimin e datës 27.07.2020 për caktimin e zëvendësuesit të Zyrtarit të Lartë Tatimor;
- Vendimin e datës 06.03.2020 për caktimin e ushtrues detyre të Udhëheqësi të Divizionit të Hetimeve Tatimore;
- Vendimin e datës 06.03.2020 për caktimin e ushtrues të detyrës në pozitën Udhëheqës i Divizionit të Inteligjencës Financiare;
- Vendimin e datës 19.06.2020 për caktimin e ushtrues detyre Udhëheqës i Ekipit të Vizitave në Drejtorinë Rajonale në Pejë;
- Vendimin e datës 19.06.2020 për caktimin e ushtrues detyre Udhëheqës i Ekipit në ZGJONA në Drejtorinë Rajonale në Pejë;
- Vendimin e datës 27.07.2020 për caktimin e ushtrues detyre Udhëheqës i Ekipit të Kontrollit në Drejtorinë Rajonale në Mitrovicë;

- Vendimin e datës 27.07.2020 për caktimin e ushtrues detyre Udhëheqës i Ekipit në Divizionit QESHT;
- Vendimin e datës 16.10.2020 për caktimin e zëvendësuesit Drejtor i Departamentit të Shërbimit dhe ZGJONA për Pr. 1, 2 dhe 3;
- Vendimet e datës 03.02.2020 për ri caktimin e Drejtorëve Rajonal, Ferizaj, Pejë, Prishtinë, Prishtina 3, Prizren 2, Gjakovë, Mitrovicë, Prishtina 2;
- Vendimin e datës 24.01.2020 për transferimin në pozitë Udhëheqës i Divizionit për Mbledhjen e Burgjeve të Reja;
- Vendimin e datës 30.01.2020 për transferimin në Inspektor i Kontrollit në Drejtorinë Rajonale Prishtina 1;
- Vendimin e datës 05.02.2020 për transferimin në Zyrtar i Lartë Tatimor;
- Vendimin e datës 05.02.2020 për transferimin në pozitën Zyrtar i Lartë për Rimbursime;
- Vendimin e datës 11.02.2020 për transferimin në Udhëheqës të Divizionit të Hetimeve Tatimore;
- Vendimin e datës 10.06.2020 për transferimin në Zyrtar të Kontributeve Pensionale;
- Vendimin e datës 23.01.2020 për transferimin në Inspektor Tatimor në DTM;
- Vendimin e datës 05.02.2020 për transferimin në pozitën Zyrtar i Lartë për Rimbursime;
- Dosjen e nëpunësit Inspektor Tatimor Niveli 1;
- Dosjen e nëpunësit Inspektor Tatimor Niveli 2;
- Dosjen e nëpunësit civil Këshilltar;
- Dosjen e nëpunësit Inspektor Tatimor;
- Dosjen e nëpunësit Inspektor i Kontrollit;
- Vendimin e datës 13.10.2020 për pezullim të dakorduar të marrëdhënies së punës;
- Vendimin e datës 29.05.2019, 10.03.2020, 15.04.2020, 07.12.2016, 14.02.2020 për pezullim parandalues;
- Vendimin e datës 19.03.2020, 06.02.2020 dhe 25.03.2020 për ndërprerje të marrëdhënies së punës me dorëheqje
- Lista në EXEL e dërguar në DMZP për deklaram të statusit të zyrtarit publik;
- Vendimin e datës 08.09.2020, 18.02.2020, 10.01.2020 dhe 14.09.2020 për pushim pa pagesë dhe kërkesat për pushim pa pagesë;
- Vendimin e datës 04.04.2020, 03.11.2020, 04.11.2020 për pushim të lehonisë;
- Formularin për vlerësimin e punës provuese për Inspektor Tatimor datë 10.09.2020 dhe Zhvillues dhe Administrator i Sisteme Softverike i datës 12.10.2020;
- Vendimin e datës 11.08.2020 për emërimin e Komisionit Disiplinor, Vendimin e datës 08.02.2021 për shfuqizimin e vendimit të datës 11.08.2020;
- Vendimin e datës 07.07.2021 për emërimin e Komisionit Disiplinor;
- Emailin e Njesisë së Burimeve Njerëzore lidhur me vlerësimet e rezultateve në punë për vitin 2020;
- Kontratë punë për kohë të pacaktuar e datës 29.09.2017, 30.03.2018, 29.09.2017, për vozitës;
- Akt Emërimet e datës 14.02.2013, 01.10.2012, 31.01.2013, 01.10.2012, 28.12.2015, 01.10.2012, 01.10.2012, 01.10.2012, 26.03.2012 dhe 24.12.2012 për pozitën Vozitës;
- Marrëveshje për Shërbime të Veçanta e datës 27.12.2019 dhe 01.04.2020;
- Vendimin e datës 04.03.2020, 08.01.2020, 03.07.2020, 02.11.2020 për pagesën me rastin e pensionimit;

Kolegji i Këshillit për monitorimin e zbatimit të legjislacionit për shërbimin civil, duke u bazuar në provat dhe dëshmitë e shqyrtuara për fushat e monitorimit të përfshira në “pyetësor”, ka konstatuar të gjeturat dhe ka dhënë rekomandimet përkatëse për zyrtarët përgjegjës të institucionit si në vijim:

1. OGANIZIMI I BRENDSHËM DHE TË DHËNAT E TË PUNËSUARVE

Kolegji i Këshillit për monitorimin e zbatimit të legjislacionit për shërbimin civil, gjatë vizitës që ka bërë në Administratën Tatimore të Kosovës më datë me datë 07.04.2021 dhe 23.12.2021, ka konstatuar që ky institucion ka në fuqi Rregulloren për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës në Administratën Tatimore të Kosovës të vitit 2019. Në këtë institucion janë të punësuar 819 nëpunës civil, ndërsa 15 pozita janë të lira.

- Gjatë vizitës Kolegji i Këshillit për monitorimin e zbatimit të legjislacionit për shërbimin civil ka shqyrtuar dosjet e personelit dhe ka konstatuar se janë shqyrtuar pesë (5) dosje të nëpunësve civil ndërsa si kopje janë marrë tri (3) dosje atë për pozitën “Inspektor Tatimor”, “Këshilltare” dhe “Inspektor Tatimor” dhe në bazë të vlerësimit të gjitha dosjet personale janë të ruajtura në sirtar të sigurt, mirëpo në bazë të shqyrtimit të dosjeve është konstatuar që dosjet e personelit nuk kanë qenë të kompletuara, sepse nuk janë përfshirë në dosje kërkesat e pushimeve, formularët e vlerësimit të rezultateve në punë dhe formularët e përmbajtjes së dosjeve personale të nëpunësit civil, respektivisht fletën prezantuese.
- Gjatë shqyrtimit të dosjeve kemi vërejtur që janë dhjetë (10) pozita të Vozitëseve në Administratën Tatimore të Kosovës të cilët kanë akt emërimi.
- Kolegji duke u bazuar në dëshmitë e ofruara ka konstatuar se në këtë institucion gjatë vitit 2020 ka pasur 30 pozita me ushtrues të detyrës.
- Bazuar në deklaratimet e Udhëheqësit të Njesisë së Burimeve Njerëzore në Administratën Tatimore të Kosovës, ky institucion ka dërguar në Departamentin për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë të Ministrisë së Punëve të Brendshme, listën për deklarimin e statusit të zyrtarëve publikë, mirëpo ende nuk ka përfunduar si proces.

Kolegji gjatë shqyrtimit të kësaj fushe ka gjetur:

E GJETURA 1: Kolegji i Këshillit për monitorimin e zbatimit të legjislacionit për shërbimin civil, gjatë shqyrtimit të dosjeve të personelit, ka konstatuar që dosja për pozitën “Inspektor Tatimor”, “Këshilltare” dhe “Inspektor Tatimor”, në dosje nuk janë formularët e vlerësimit të rezultateve në punë. Në dosje të personelit nuk janë të vendosur kërkesat e pushimeve pasi që në këtë institucion evidenca e pushimeve mbahet vetëm në mënyrë elektronike. Po ashtu dosjet e personelit nuk e përmbajnë formularin e përmbajtjes së dosjeve personale të nëpunësit civil, respektivisht fletën prezantuese, më këtë Kolegji vlerëson se nuk janë respektuar dispozitat e nenit 5 paragrafi 1 nën paragrafët 1.1 dhe 1.17 të Rregullores Nr. 03/2011 mbi Dosjet dhe Regjistrin Qendror të Nëpunësve Civil, dhe dispozitat e nenit 4 paragrafit 3 të Rregullores (MPB) Nr. 01/2020 për Përmbajtjen, Administrimin dhe Përdorimin e Dosjes së Personelit dhe Sistemit Informativ të Menaxhimit të Burimeve Njerëzore, respektivisht shtojcës 1.1 pika 17 të kësaj rregulloreje, sepse Dosja personale e zyrtarit publikë duhet të shoqërohet nga fleta prezantuese e krijuar nga zyrtari përgjegjës i Njesisë së menaxhimit të burimeve njerëzore e cila ka formën dhe përmbajtjen sipas shtojcës nr. 1.2, ndërsa Fleta prezantuese sipas paragrafit 3 të këtij neni nënshkruhet nga zyrtari i autorizuar i njesisë së menaxhimit të burimeve njerëzore të institucionit përkatës dhe nga vetë zyrtari publik, për të cilin

është krijuar dosja personale siç parashihet me paragrafin 4 të këtij neni. Po ashtu dosjet e personelit duhet të jenë të kompletuara sipas përmbajtjes që kërkohet me shtojën 1.1 të kësaj rregulloreje.

Rekomandimi 1: Rekomandojmë Udhëheqësin e Njesisë së Burimeve Njerëzore të Administratës Tatimore të Kosovës që të ndërmarr të gjitha veprimet e nevojshme, që të gjitha dosjet e personelit të jenë në pajtim me dispozitat e Rregullores (MPB) Nr. 01/2020 për Përmbajtjen, Administrimin dhe Përdorimin e Dosjes së Personelit dhe Sistemit Informativ të Menaxhimit të Burimeve Njerëzore.

E GJETURA 2: Kolegji i Këshillit për monitorimin e zbatimit të legjislacionit për shërbimin civil, gjatë shqyrtimit të dosjeve, dhe deklarimeve të Udhëheqësit të Njesisë së Burimeve Njerëzore, ka konstatuar që gjatë vitit 2021 ka pasur 30 pozita me ushtrues detyre respektivisht me zëvendësime, kështu që gjatë shqyrtimit të këtyre vendimeve kemi konstatuar që kryesisht baza juridike e nxjerrjes së këtyre vendimeve është Ligji Nr. 06/L-113 për Organizimin dhe Funksionimin e Administratës Shtetërore dhe Agjencive të Pavarura. Kolegji vlerëson së rastet që i referohet Ligjit Nr. 06/L-113 për Organizimin dhe Funksionimin e Administratës Shtetërore dhe Agjencive të Pavarura lidhur me zëvendësim janë rastet kur nëpunësi civil përkohësisht nuk e ushtron pozitën (pushim vjetor, mjekësor, trajnim apo të ngjashme), ndërsa aplikimi i dispozitave të nenit 32 paragrafi 4 të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë i referohet rastet kur nëpunësit mungojnë në punë deri në dymbëdhjetë muaj (pushim i lehonisë, pezullim i marrëdhënies së punës e të ngjashme).

Meqenëse pozitat sipas të gjeturës kanë qenë pozita të lira, atëherë sipas Kolegji nuk mund të aplikohen dispozitat e Ligjit Nr. 06/L-113 për Organizimin dhe Funksionimin e Administratës Shtetërore dhe Agjencive të Pavarura respektivisht dispozitat e nenit 32 paragrafi 4 të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë, por plotësimi i pozitave është dashur të bëhet përmes transferimit të përkohshëm, procedurave të lëvizjes brenda kategorisë apo ngritjes në detyrë.

Rekomandimi 2: Rekomandojmë Drejtorin e Përgjithshëm dhe Udhëheqësin e Njesisë së Burimeve Njerëzore të Administratës Tatimore të Kosovës që të ndërmarr veprimet e nevojshme që plotësimi i pozitave të lira që të aplikohen dispozitat e Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë.

E GJETURA 3: Kolegji i Këshillit për monitorimin e zbatimit të legjislacionit për shërbimin civil në Administratën Tatimore të Kosovës, në pyetjen e bërë Udhëheqësit të Njesisë së Burimeve Njerëzore se a është përfunduar deklarimi i statusit të zyrtarëve publikë, kemi pranuar përgjigje që lista e zyrtarëve është dërguar në Departamentin për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë të Ministrisë së Punëve të Brendshme, mirëpo ende nuk ka përfunduar si proces. Lidhur me këtë, Kolegji konstaton se deklarimi i statusit të zyrtarëve publikë ka qenë obligim ligjor që të përfundohet brenda afateve ligjore të përcaktuar me dispozitat e Rregullores (QRK) Nr.10/2020 Për Deklarimin e Statusit të Zyrtarëve Publikë.

Rekomandimi 3: Rekomandojmë Udhëheqësin e Njesisë së Burimeve Njerëzore të Administratës Tatimore të Kosovës në bashkëpunim me Departamentin për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë të Ministrisë së Punëve të Brendshme që të bëjë deklarin e statusit të zyrtarëve publikë, sipas dispozitave të nenit 83 të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë dhe dispozitave të Rregullores (QRK) Nr.10/2020 Për Deklarimin e Statusit të Zyrtarëve Publikë, të arsyetuar me vendim sipas Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative.



E GJETURA 4: Kolegji i Këshillit për monitorimi e zbatimit të legjislacionit për shërbimin civil në Administratën Tatimore të Kosovës, ka vërejtur që dhjetë Vozitës kanë akt emërime me afat të pacaktuar, ndërsa që pozitat e vozitësve nuk janë shërbyes civil sipas nenit 4 paragrafi 4 i Ligjit Nr. 04/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, ndërsa në vitin 2014 Ministria e Administratës Publike ka lëshuar Qarkoren Administrativë me të cilën ka përcaktuar se kush nga të punësuar nuk ka statusin e nëpunësit civil në mesin e tyre edhe vozitësit, mirëpo Administrata Tatimore e Kosovës nuk ka marr veprimet e nevojshme për zëvendësimin e akt emërimeve në kontrata pune sipas Ligjit të Punës. Po ashtu edhe Ligji Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë në nenin 2 paragrafi 6 ka përcaktuar se vozitësi janë nëpunës administrativo-teknik - dhe mbështetës, kështu që meqë nuk është bërë ky zëvendësim atëherë ka qenë obligim ligjor që të bëhet deklarimi i statusit të zyrtarit publikë.

Rekomandimi 4: Rekomandojmë Drejtorin e Përgjithshëm dhe Udhëheqësin e Njesisë së Burimeve Njerëzore të Administratës Tatimore të Kosovës, që të ndërmarr të gjitha veprimet ligjore për eliminimin e kësaj shkelje dhe të veproj në përputhje me dispozitat e nenit 83 të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë dhe dispozitave të Rregullores (QRK) Nr.10/2020 Për Deklarimin e Statusit të Zyrtarëve Publikë.

2. PROCEDURAT E REKRUTIMIT DHE TË AVANCIMIT

Kolegji i Këshillit për monitorimin e zbatimit të legjislacionit për shërbimin civil, ka konstatuar se Administrata Tatimore e Kosovës ka përgatitur planin e personelit dhe gjatë vitit 2020 mirëpo nuk ka zhvilluar asnjë procedurë të rekrutimit për shkak të ndryshimit të legjislacionit, vetëm që një procedure që u shpallur në vitin 2020 është përfunduar në vitin 2020 por që Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës e ka vlerësuar që është zhvilluar në pajtim me legjislacionin në fuqi.

Po ashtu në këtë institucion janë lidhur dy kontrata me marrëveshje për shërbime të veçanta për të cilat nuk ka pasur procedurë rekrutimit. Këto marrëveshje janë lidhur për një periudhë më të shkurtër se gjashtë muaj

Pas analizimit janë konstatuar këtë të gjetur:

E GJETURA 1: Kolegji për monitorimin e zbatimit të legjislacionit për shërbimin civil, gjatë shqyrtimit të dosjeve të të punësuarve me marrëveshje për kryerjen e shërbimeve të veçanta, ka konstatuar se Administrata Tatimore e Kosovës për vitin 2020 ka pasur të angazhuar dy të punësuar me marrëveshje për shërbime të veçanta të cilët kanë qenë të angazhuar për një periudhë më të shkurtër se gjashtë (6) muaj, mirëpo nuk ka pasur procedurë të zhvilluar për lidhjen e këtyre kontratave që është në kundërshtim me nenin 12 paragrafin 4 të Ligjit Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës.

Me hyrjen në fuqi të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, çështja e lidhjes së marrëveshjeve të shërbimeve të veçanta është e rregulluar me Ligjin e Prokurimit Publikë, andaj meqenëse kontratat sipas të gjeturës nuk janë në fuqi, nuk është dhënë rekomandim.

3. PROCEDURAT DISIPLINORE

Kolegji i Këshillit për monitorimin e zbatimit të legjislacionit për shërbimin civil, ka konstatuar se Administrata Tatimore e Kosovës në bazë të Vendimit me Nr.Prot:09.06.2429 të datës 11.08.2020

ka të themeluar Komisionin Disiplinor i cili është i themeluar me tre (3) anëtar të përhershëm me mandat tre (3) vjeçar, mirëpo me Vendimin me Nr. Prot:09-06-702 të datës 08.02.2021 është shfuqizuar me arsyetimin që nuk është në harmoni me kriteret e përcaktuar me Ligjin për Zyrtarët Publikë dhe nenin 10 paragrafi 2 të Rregullores Nr. 10/2020 për Disiplinën dhe Ankesat e Zyrtarëve Publikë. Më datë 07.07.2021 është nxjerr Vendimin me Nr. Prot:09-06-3309 me të cilin është themeluar Komisioni Disiplinor me tre (3) anëtar me mandat tre (3) vjeçar. Gjatë vitit 2020 kanë qenë të zhvilluara dy procedura disiplinore dhe është shqiptuar një masë.

Në këtë fushë Kolegji për monitorim ka gjetur:

E GJETURA 1: Kolegji për monitorimin e zbatimit të legjislacionit për shërbimin civil, gjatë shqyrtimit të Vendimit me Nr. Prot: 09-06-3309 të datës 07.07.2021 për themelimin të Komisionit Disiplinor, ka konstatuar se tek anëtarët e komisionit është përshkruar vetëm “kryesues dhe anëtarët”, ndërsa nuk janë përshkruar pozitat e kryesuesit dhe anëtareve të këtij komisioni. Ligji Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë në nenin 49 paragrafi 5 ka përcaktuar që Qeveria, me propozimin e ministrit për përgjegjëse për administratën publike, me akt nënligjor, miraton rregullat e hollësishme për themelimin, përbërjen, përzgjedhjen dhe vendimmarrjen në komisionin disiplinor, kështu që me Rregulloren (QRK) Nr. 11/2020 për Disiplinën dhe Ankesat e Zyrtarëve Publikë janë miratuar rregullat e hollësishme për këtë fushë, ku neni 10 ka përcaktuar mënyrën e themelimit të Komisionit Disiplinor. Bazuar në 10 paragrafi 2 përcaktohet që: “Komisioni disiplinor përbëhet nga tre (3) anëtarë të cilët duhet të jenë nëpunës civilë, nga të cilët njëri duhet të jetë jurist dhe ka këtë përbërje: Nëpunës civil i nivelit drejtues –Kryesues i Komisionit; Nëpunës civil i nivelit profesional –anëtar dhe Nëpunës civil i njësisë së burimeve njerëzore – anëtar”. Meqenëse kjo dispozitë ka përcaktuar që duhet të përshkruhen edhe pozitat e kryesuesit dhe anëtarëve të Komisionit Disiplinor, atëherë Administrata Tatimore e Kosovës nuk ka bërë një përshkrim të tillë, rrjedhimisht edhe fryma e normës nuk është zbatuar si tersi.

Rekomandimi 1: Rekomandojmë Drejtorin e Përgjithshëm të Administratës Tatimore të Kosovës, që bëjë plotësim/ndryshimin e vendimit të Komisionit Disiplinor dhe në vendim të përshkruhen edhe pozitat që mbajnë kryesuesi dhe anëtarët siç parashihet me nenin 10 të Rregulloren (QRK) Nr. 11/2020 për Disiplinën dhe Ankesat e Zyrtarëve Publikë.

4. PROCEDURAT E ANKESAVE

Kolegji i Këshillit për monitorimin e zbatimit të legjislacionit për shërbimin civil, ka konstatuar se Administrata Tatimore e Kosovës në bazë të Vendimit të datës 20.02.2019 ka pasur të themeluar Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave i cili është i themeluar me tre (3) anëtar të përhershëm me mandat dy (2) vjeçar, mirëpo pas hyrjes në fuqi të Ligjit për Zyrtarët publikë është nxjerr vendimi i datës 11.08.2020 me të cilin i ka përfunduar mandati këtij komisioni sepse sipas këtij ligji nuk është paraparë Komision për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave për nëpunësit civil.

Për këtë fushë të monitorimit kolegji nuk ka gjetur shkelje dhe nuk ka dhënë rekomandime.

5. PROCEDURAT E VLERËSIMIT

Kolegji i Këshillit për monitorimin e zbatimit të legjislacionit për shërbimin civil, ka konstatuar se Administratën Tatimore të Kosovës, nuk ka bërë vlerësimin e rezultateve në punë për të gjithë

nëpunësit civil pasi që për 58 nëpunës civil nuk është bërë vlerësimi po ashtu nuk janë respektuar afatet e vlerësimit për disa nga nëpunësit të cilëve i është kryer vlerësimi.

Në vitin 2020 ka pasur 25 raste kur nëpunësve civil i'u është dashur ti kryer vlerësimi i periudhës provuese.

Lidhur me procedurën e vlerësimit kemi gjetur:

E GJETURA 1: Kolegji i Këshillit për mbikëqyrjen e zbatimit të legjislacionit për shërbimin civil, ka konstatuar se në dosjet personale ka konstatuar se për 58 nëpunës civil të Administratës Tatimore të Kosovës nuk është bërë vlerësimi i rezultateve të punës për vitin 2020 edhe pse Zyra e Personelit ka përcjell e-mailin tek udhëheqësit e drejtpërdrejtë të nëpunësve që vlerësimi i rezultateve të punës duhet të bëhet brenda afateve ligjore, në këtë rast mos vlerësimi i rezultateve të punës për të gjithë nëpunësit civil është shkelje e dispozitave të nenit 43 Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrarët Publikë dhe dispozitave të Rregullores Nr. 21/2020 për Procedurën e Vlerësimit të Rezultateve në Punë të Nëpunësve Civil dhe Nëpunësve të Shërbimeve Publike. Po ashtu në disa raste vlerësimet e rezultateve në punë për nëpunësit civil janë bërë pas datës 31.01.2021, që janë jashtë afateve ligjore, që është në kundërshtim me nenin 43 paragrafi 1 të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrarët Publikë dhe nenin 8 paragrafi 2 të Rregullore Nr. 21/2020 për Procedurën e Vlerësimit të Rezultateve në Punë të Nëpunësve Civil dhe Nëpunësve të Shërbimeve Publike, sepse vlerësimi i rezultateve në punë për nëpunësi civil duhet të bëhet deri më datë 31 Janar të vitit të ardhëm për vitin paraprak.

Ligji Nr. 06/L-114 për Zyrarët Publikë ka përcaktuar që Zyrarët Publikë duhet t'i ushtrojnë detyrat dhe përgjegjësit konform këtij ligji, në këtë rast mos vlerësimi i rezultateve në punë për nëpunësit civil është mos përmbushje e detyrave të punës nga menaxherët drejtues.

Rekomandimi 1: Rekomandojmë Drejtorin e Përgjithshëm të Administratës Tatimore të Kosovës që të ndërmarr veprimet e nevojshme përmes të cilave sigurohet që të gjithë nëpunësve civil i'u është bërë vlerësimi i rezultateve të punës sipas dispozitave të nenit 43 Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrarët Publikë dhe dispozitave të Rregullores Nr. 21/2020 për Procedurën e Vlerësimit të Rezultateve në Punë të Nëpunësve Civil dhe Nëpunësve të Shërbimeve Publike.

E GJETURA 2: Kolegji i Këshillit për monitorimin e zbatimit të legjislacionit për shërbimin civil, ka konstatuar se për 25 nëpunës civil është kryer vlerësimi i periudhës provuese dhe ne kemi vlerësuar dosjen e nëpunësit civil për pozitën "Inspektor Tatimor" dhe kemi konstatuar që Akt Emërimi nëpunësit për këtë pozitë e kanë nënshkruar më datë 01.09.2019, ndërsa vlerësimi i periudhës provuese është bërë më datë 01.09.2020, kështu që Kolegji ka konstatuar që nuk janë respektuar afatet për vlerësim të punës provuese siç parashihet me Kapitullin III respektivisht nenin 37 dhe 38 të Rregullores (QRK) Nr. 16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës.

Rekomandimi 2: Rekomandojmë Drejtorin e Përgjithshëm dhe Udhëheqësin e Njesisë së Burimeve Njerëzore në Administratën Tatimore të Kosovës, që të ndërmerr masat që në të ardhmen për të gjithë nëpunësit civil që janë në periudhë provuese, vlerësimi t'i bëhet duke u respektuar procedurat dhe afatet sipas Kapitullit III të Rregullores (QRK) Nr. 16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës.

6. PROCEDURAT E PUSHIMEVE

Kolegji i Këshillit për mbikëqyrjen e zbatimit të legjislacionit për shërbimin civil, ka konstatuar se Administrata Tatimore e Kosovës evidencën e pushimeve të nëpunësve civil e mban vetëm në kopje elektronike. Për periudhën e monitorimit disa nëpunës civil kanë shfrytëzuar pushimin mjekësor dhe në bazë të vlerësimit të dosjeve këto pushime i kanë dëshmuar me raporte mjekësore. Dymbëdhjetë (12) nëpunës civil ka realizuar pushimin pa pagesë dhe në dosje ka pasur kërkesën dhe vendimin, po ashtu pesë (5) nëpunëse civile kanë realizuar pushimin e lehonisë.

Për evidencën e pushimeve vjetore dhe mjekësore kemi konstatuar këtë të gjetur:

E GJETURA 1: Kolegji gjatë shqyrtimit të dosjeve ka vërejtur se nëpunësit civil edhe pse realizojnë pushimet vjetor, kërkesat i bëjnë përmes sistemit elektronik, mirëpo nuk i sjellin kërkesat në mënyrë fizike. Sipas Rregullores (MPB) Nr. 01/2020 për Përmbajtjen, Administrimin dhe Përdorimin e Dosjes së Personelit dhe Sistemit Informativ të Menaxhimit të Burimeve Njerëzore, dosjet e personelit përmbajnë evidenca, vendimet, dëshmitë tjera të pushimeve të parapara me Ligj, ndërsa sipas deklaratës së Udhëheqësit të Njesisë së Burimeve Njerëzore nëpunësit civil kërkesat fizike të pushimit vjetor nuk i sjellin në mënyrë që të përfshihen në dosjen e nëpunësit civil.

Rekomandimi 1: Rekomandojmë Udhëheqshin e Njesisë së Burimeve Njerëzore së Administratës Tatimore të Kosovës, që të ndërmerr masat, që në dosjet personale të nëpunësve civil të jenë edhe kërkesat fizike të pushimit vjetor, siç parashihet me dispozitat e Rregullores (MPB) Nr. 01/2020 për Përmbajtjen, Administrimin dhe Përdorimin e Dosjes së Personelit dhe Sistemit Informativ të Menaxhimit të Burimeve Njerëzore.

7. PROCEDURAT E TRANSFERIMIT

Kolegji i Këshillit për monitorimin e zbatimit të legjislacionit për shërbimin civil, ka konstatuar se në Administratën Tatimore të Kosovës gjatë vitit 2020 ka pasur 50 transferime të brendshme, ndërsa gjatë shqyrtimit të vendimeve kemi gjetur:

E GJETURA 1: Kolegji i Këshillit për monitorimin e zbatimit të legjislacionit për shërbimin civil, gjatë shqyrtimit të Vendimit me Nr.97 të datës 05.02.2020, ka konstatuar se Udhëheqësi i Ekipit në Drejtorinë Rajonale në Pejë është transferuar në mënyrë të përhershme në pozitën Zyrtar i Lartë për Rimbursime, bazuar në riorganizimin e Administratës Tatimore të Kosovës. Lidhur me këtë rast konstatojmë që fillimisht ka qenë obligim i institucionit që me rastin e riorganizimit të veproj në pajtim me nenin 32 paragrafit 1 dhe 2 të Ligjit Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, e pastaj nëse nuk ka pozitë të lirë ekuivalente të sistemoj në pozitë që i përshtatet përgatitjes profesionale dhe përvojës së punës.

Rekomandimi 1: Rekomandojmë Drejtorin e Përgjithshëm të Administratës Tatimore të Kosovës që të bëjë eliminimin e shkëljes dhe të gjithë nëpunësit civil që janë transferuar në formë të tillë të kthehen në vendet e tyre paraprake, dhe të shfuqizohen vendimet konform Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative.

E GJETURA 2: Kolegji i Këshillit për monitorimin e zbatimit të legjislacionit për shërbimin civil, gjatë shqyrtimit të vendimeve për transferim të përhershëm në pozita ekuivalente, në asnjë vendim nuk kemi hasur që është përshkruar që ka pëlqim të nëpunësit civil për transferim në pozitë tjetër.

Në rastet e tilla ka qenë e nevojshme të jetë edhe pëlqimi i nëpunësit civil sipas nenit 8 të Rregullores Nr. 06/2010 për Transferimin e Nëpunësve Civilë.

Rekomandimi 2: Rekomandojmë Drejtorin e Përgjithshëm dhe Udhëheqësin e Njesisë së Burimeve Njerëzore të Administratës Tatimore të Kosovës, që të ndërmerr të gjitha veprimet për eliminimin e shkeljeve të konstatuar sa i përket transferimeve të përhershme, që janë bërë në kundërshtim me nenin 8 të Rregullores Nr. 06/2010 për Transferimin e Nëpunësve Civilë.

E GJETURA 3: Kolegji i Këshillit për monitorimin e zbatimit të legjislacionit për shërbimin civil, gjatë shqyrtimit të vendimeve për transferim të Drejtorëve Rajonal brenda Administratës Tatimore të Kosovës ku këtyre drejtorëve i'u kanë ndërruar lokacioni i vendit të punës por jo pozita. Sipas njoftimit të Udhëheqëses së Njesisë së Burimeve Njerëzore këta drejtor kanë qenë të transferuar për periudhë një vjeçare dhe pas një viti janë kthyer në vendet ku kanë qenë të caktuar, mirëpo në vendime nuk ka qenë e përcaktuar periudha e transferimit. Por në këto raste ka pasur shkelje procedurale dhe materiale gjatë transferimit të tyre sepse pozitat drejtues nuk mund të transferohen përkohësisht më shumë se gjashtë muaj sipas nenit 16 të Ligjit Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Kosovës.

Meqë këta nëpunës janë kthyer në vendet ku kanë qenë të caktuar, nuk kemi dhënë rekomandime.

8. TË DHËNAT PËR PËRFAQËSIM ETNIK, GJINOR DHE PERSONAVE ME NEVOJA TË VEÇANTA

Kolegji i Këshillit për monitorimin e zbatimit të legjislacionit për shërbimin civil, ka konstatuar se Administrata Tatimore e Kosovës ka të punësuar 819 nëpunës civil prej tyre 779 janë shqiptar, 32 serb, 2 turq dhe 6 tjerë, prej tyre 270 janë të punësuar femra ndërsa 549 janë meshkuj, ndërsa në këtë institucion nuk është i punësuar asnjë nëpunës civil nga personat me aftësi të kufizuara.

Në këtë fushë kemi konstatuar këtë të gjetur:

E GJETURA 1: Kolegji i Këshillit për monitorimin e zbatimit të legjislacionit për shërbimin civil, ka konstatuar se prej 819 nëpunësve civil të punësuar në Administratën Tatimore të Kosovës 270 janë të punësuar femra ndërsa 549 janë të punësuar meshkuj çka nënkupton se nuk ka numër të barabartë të punësuarve në aspektin gjinor ashtu siç përcaktohet me dispozitat e nenit 6 paragrafit 8 të Ligjit Nr. 05/L-020 për Barazi Gjinore.

Rekomandim 1: Rekomandojmë Drejtorin e Përgjithshëm të Administratës Tatimore të Kosovës që të ndërmarr të gjitha veprimet për zbatimin e dispozitave të nenit 6 paragrafit 8 të Ligjit Nr. 05/L-020 për Barazi Gjinore.

E GJETURA 2: Kolegji i Këshillit për monitorimin e zbatimit të legjislacionit për shërbimin civil, ka konstatuar se prej 819 nëpunësve civil të punësuar në Administratën Tatimore të Kosovës nuk është i punësuar asnjë person nga personat me aftësi të kufizuara, me çka nënkuptohet se nuk është respektuar dispozita e nenit 12 paragrafit 2 të Ligjit Nr. 03/L-019 për Aftësimin, Riaftësimin Profesional dhe Punësimin e Personave me Aftësi të Kufizuara, pasi që për çdo 50 të punësuar në shërbim civil një duhet me qenë person me nevoja të veçanta.

Rekomandimi 2: Rekomandojmë Drejtorin e Përgjithshëm të Administratës Tatimore të Kosovës, që të ndërmarr të gjitha veprimet për zbatimin e nenit 12 të Ligjit Nr. 03/L-019 për Aftësimin, Riaftësimin Profesional dhe Punësimin e Personave me Aftësi të Kufizuara pasi që çdo punëdhënës është i obliguar të punësojë një person me aftësi të kufizuara në çdo pesëdhjetë (50) punëtor.

9. PEZULLIMI, NDËRPRERJA DHE PËRFUNDIMI I MARRËDHËNIES SË PUNËS

Kolegji i Këshillit për monitorimin e zbatimit të legjislacionit për shërbimin civil, ka konstatuar në Administratën Tatimore të Kosovës, pesë (5) nëpunës civil janë në pezullim parandalues me 50% të pagës, pezullim të dakorduar një rast. Në bazë të vlerësimit të dosjeve tre (3) nëpunësve civilë i është ndërprerë marrëdhënia e punës me dorëheqje për të cilët ka pasur kërkesë për dorëheqje dhe vendim. Në bazë të vlerësimit të dosjeve është konstatuar që 12 nëpunësve civil i është përfunduar marrëdhënia e punës për shkak të arritjes së moshës së pensionimit të cilëve i është bërë pagesa e një page të njëhershme në pajtim me legjislacionin në fuqi, një (1) nëpunës civil i është përfunduar marrëdhënia e punës me vdekje, ndërsa nuk ka asnjë nëpunës civil që i është përfunduar marrëdhënia e punës për shkak (ushtrimit të detyrave për arsye shëndetësore, përfundimit të afatit për punësi me afat të caktuar, dënimin nga një gjykatë penale me vendim të formës së prerë).

Në këtë fushë të kemi gjetur:

E GJETURA 1: Kolegji i Këshillit për monitorimin e zbatimit të legjislacionit për shërbimin civil, ka konstatuar se sipas të dhënave nga Udhëheqësja e Njesisë së Burimeve Njerëzore në Administratën Tatimore të Kosovës, gjatë vitit 2020 një nëpunës civil i institucionit ka vdekur, por ka theksuar që nuk është nxjerr vendim për përfundimin e marrëdhënies së punës për këtë rast dhe familja nuk është kompensuar me një pagë me rastin e vdekjes së anëtarit të familjes. Në bazë të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë në nenin 60 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 është paraparë që marrëdhënia e punës në Shërbimin Civil përfundon për shkak të ligjit, kur: nëpunësi vdes apo kur merr formë të prerë vendimi për deklarimin e vdekjes së tij, kështu që përfundimi i marrëdhënies së punës në këtë rast bëhet me vendim nga Njësia e Burimeve Njerëzore e institucionit, ku nëpunësi ushtron detyrën brenda afateve sipas paragrafit 4 të këtij neni.

Po ashtu me nenin 22 paragrafin 2 nën paragrafin 2.4 të Ligjit Nr. 03/L-147 për Pagat e Nëpunësve Civil dhe nenin 22 paragrafin 1 të Rregullores Nr. 33/2012 për Shtesat në Pagë dhe Kompensime të Tjera të Nëpunësve Civilë është paraparë familjes së ngushtë të nëpunësit civil duhet ti bëhet pagesa e një page të njëhershme në vlerën e një page mujore.

Rekomandimi 1: Rekomandojmë Udhëheqësin e Njesisë së Burimeve Njerëzore të Administratës Tatimore të Kosovës, në rastet kur ka vdekje të nëpunësve civil të institucionit të nxirret vendim për përfundimin e marrëdhënies së punës sipas Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë, si dhe të kompensohet familja sipas Ligjit Nr. 03/L-147 për Pagat e Nëpunësve Civil dhe Rregullores Nr. 33/2012 për Shtesat në Pagë dhe Kompensime të Tjera të Nëpunësve Civilë.

10. PAPAJTUESHMËRIA NË MES TË USHTRIMIT TË DETYRËS SË NËPUNËSIT CIVIL DHE FUNKSIONARIT PUBLIK

Kolegji i Këshillit për monitorimin e zbatimit të legjislacionit për shërbimin civil, ka konstatuar në Administratën Tatimore të Kosovës nuk ka asnjë nëpunës civil i cili në të njëjtën kohë mban pozitë të shërbimit civil dhe ndonjë post publik.

Për këtë fushë të monitorimit kolegji nuk ka gjetur shkelje dhe nuk kemi rekomandime.

11. TË DHËNAT NËSE NDAJ NËPUNËSVE CIVIL ËSHTË DUKE U ZHVILLUAR PROCEDURË PENALE OSE JANË DËNUAR ME VENDIM TË GJYKATËS

Kolegji i Këshillit për monitorimin e zbatimit të legjislacionit për shërbimin civil, ka konstatuar në Administratën Tatimore të Kosovës ndaj tre (3) nëpunës civil janë duke zhvilluar procedurë penale por ka një nëpunës që është dënuar me vendim të formës së prerë të gjykatës dhe të njëjtit i është përfunduar marrëdhënia e punës ku Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës ka vendosur me Vendimin A.nr.982/2021.

Për këtë fushë të monitorimit kolegji nuk ka gjetur shkelje dhe nuk kemi rekomandime.

12. TRAJNIMI I NËPUNËSVE CIVIL

Kolegji i Këshillit për monitorimin e zbatimit të legjislacionit për shërbimin civil, ka konstatuar se Administrata Tatimore e Kosovës ka përgatitur planin individual të trajnimeve në të cilin përfshihen fushat e trajnimit, ku për shkak të pandemisë COVID-19 nuk ka mund të realizohet në tërësi, mirëpo 382 nëpunës kanë ndjekur trajnimet.

Në këtë fushë nuk kemi të gjetur dhe nuk kemi dhënë rekomandime.

13. ORGANIZIMI I BRENDSHËM DHE KALSIFIKIMI I VENDEVE TË PUNËS

Administrata Tatimore e Kosovës ka në fuqi Rregulloren për Organizmin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës e cila është e zbatueshme por që ka draftuar Rregulloren e re duke e harmonizuar me ligjet aktuale të aplikueshme por e njëjta nuk është miratuar nga organet gjegjëse pasi që është duke u shqyrtuar nga Ministria e Punëve të Brendshme.

Në rregulloren e re ka ndryshime të pozitave sepse disa nga pozitat brenda në Administratën Tatimore të Kosovës ku Drejtorët e Drejtorive Rajonale nuk janë paraparë dhe aty do të ketë ndryshime.

14. VIJIMI NË PUNË, PAGAT, SHITESAT DHE KOMPENSIMET

Kolegji i Këshillit për monitorimin e zbatimit të legjislacionit për shërbimin civil, ka konstatuar se Administrata Tatimore e Kosovës vijimin në punë e mban në formë elektronike. Po ashtu në bazë të shqyrtimit të listës së pagave konstatohet se të gjitha pagat realizohet në pajtim me akt emërimet, ndërsa lidhur me shtesat nëpunësit civilë gëzojnë shtesë për rrezikshmëri në punë në bazë të Udhëzimit Administrativ Nr. 02/2011 për Vendosjen e Sistemit të Pagesave për Personelin e Administratës Tatimore të Kosovës.

Për këtë fushë të monitorimit kolegji nuk ka gjetur shkelje dhe nuk kemi rekomandime.

15. ZBATIMI I REKOMANDIMEVE DHE VENDIMEVE TË KËSHILLIT

Kolegji i Këshillit për monitorimin e zbatimit të legjislacionit për shërbimin civil, ka konstatuar se Administrata Tatimore e Kosovës gjatë vitit 2020 ka pranuar dymbëdhjetë (12) vendime të Këshillit prej të cilave për shtatë (7) vendime ka qenë e obliguar të zbatojë.

Administrata Tatimore e Kosovës në vitin 2018 është monitoruar për vitin 2017 mirëpo nuk është miratuar raporti për shkak që Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil i Kosovës ka qenë jo funksional.

16. NGACMIMET SEKSUALE

Gjatë vizitës së monitorimit nuk na është raportuar asnjë rastë në këtë fushë dhe për këtë nuk kemi të gjetur dhe rekomandim.

17. SHËNIMET/KOMENTET/KONKLUZIONET E PËRGJITHSHËM PËR MIBKËQYRJEN E ZBATIMIT TË RREGULLAVE DHE PARIMEVE TË LEGJISLACIONIT PËR SHËRBIMIN CIVIL

Kolegji i Këshillit gjatë shqyrtimit dhe monitorimit të të dhënave të dosjeve për fushat e monitorimit, ka konstatuar pesëmbëdhjetë (15) të gjetura dhe ka dhënë trembëdhjetë (13) rekomandime.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, rekomandon menaxhmentin e lartë të Administratës Tatimore të Kosovës, që gjetjet me rekomandimet e dhëna në këtë raport t'i adresoj dhe së bashku me njësitë përgjegjëse të sigurojë që të ketë zbatim të plotë të legjislacionit për shërbimin civil, sidomos duke pasur një fokus të veçantë për fushat për të cilat janë evidentuar shkelje dhe lëshime në zbatimin e procedurave dhe legjislacionit për shërbimin civil.


Eshref SHABANI
Kryetar i Kolegjit
Avdyli BEKTESHI

Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional

I dërgohet:

- Drejtorit të Përgjithshëm të Administratës Tatimore të Kosovës;
- Menaxherit të Personelit në Administratën Tatimore të Kosovës dhe
- Arkivit të KPMSHCK.